

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS , në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Mahir Tutuli, kryetar i kolegjit, Rafet Haxhaj dhe Qerim Ademaj, anëtarë, në çështjen juridike të paditësit Korporata Energjike e Kosovës sh.a divizioni i furnizimit me seli në Ferizaj të cilën e përfaqëson M.B., ndaj të paditurës N.T.P “7 Yjet” me seli në Ferizaj të cilën e përfaqëson sipas autorizimit avokati J.R., për shkak të borxhit në shumën e përgjithshme 17.987,74 euro, duke vendosur lidhur me ankesën të paditurit, të paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike, C.nr.335/2013, të datës 30.11.2015, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 10.10.2017 , mori këtë:

A K T G J Y K I M

Aprovohet ankesa e të paditurës N.T.P “7 Yjet” me seli në Ferizaj, **PRISHET** aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike, C.nr.335/2013, i datës 30.11.2015 dhe çështja i kthehet të njëjtës gjykatë në rigjykim dhe rivendosje.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktvendim ka shfuqizuar aktvendimin për lejimin e përmbarimit E.nr.1608/2011 i datës 12.03.2013 pas kundërshtimit të palës debitorë të ushtruar ndaj propozimit për përmbarim të palës kreditore, ndërsa e ka aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit Korporata Energjetike e Kosovës sh.a, duke e detyruar të paditurën që ti paguaj shumën e përgjithshme prej 17,894.44 € palës paditëse, në emër të borxhit lidhur me harxhimin e energjisë elektrike, me kamatë vjetore duke llogaritur nga data 21.11.2011 (data e paraqitjes së propozimit për përmbarim) deri në pagesën definitive të borxhit, të gjitha këto në afat kohor partitiv prej 7 ditësh, të gjitha këto nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarimit me detyrim, si dhe i ka obliguar palët që shpenzimet e procedurës kontestimore ti bartin secila veç e veç.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë i padituri për shkak të konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale dhe shpenzimeve procedurale si dhe të parashkrimit të afatit për paraqitjen e padisë duke propozuar që gjykata e shkallës së dytë, të aprovojë ankesën e të paditurës, të ndryshojë ose ta prish Aktgjykimin e ankimuar dhe çështjen ta kthej në rishqyrtim ose rivendosje.

Përgjigje në ankesë nuk ka.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë i shqyrtoi shkresat e lëndës , aktgjykimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, e pas vlerësimit të tyre në bazë të nenit 194 të LPK , gjeti se:

Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi Korporata Energjike e Kosovës sh.a divizioni i furnizimit me seli në Ferizaj, me datë 21.11.2011 pranë gjykatës së shkallës së parë, ka parashtruar propozim për përmbarim kundër të paditurës N.T.P “7 Yjet” me të cilin ka kërkuar nga gjykata në bazë të dokumentit të besueshëm Faturës që t’ia paguaj borxhin për mospagimin e energjisë elektrike në shumën e përgjithshme prej 9.157.07 euro si dhe kamatën vjetore prej 8% duke e llogaritur nga dita e paraqitjes së propozimit për përmbarim. Gjykata e shkallës së parë me Aktvendimin E. nr 1028/2013 më datë 30.09.2013 ka lejuar përmbarimin ndërsa pala debitore në afatin ligjor ka parashtruar kundërshtimin ndaj aktvendimit për lejimin e përmbarimit dhe mbi këtë bazë kjo çështje ka kaluar në procedurë kontestimore.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësja me propozimin për ekzekutim të konsideruar padi, ka kërkuar që të detyrohet e paditura N.T.P “7 Yjet”, që në emër borxhit të krijuar për pagesën e energjisë elektrike respektivisht rikthimit të humbur, t’ia paguaj paditësit shumën prej 17,894.44 € € bashku me kamatën ligjore nga data e parashtrimit të propozimit deri në pagesën definitive.

Gjykata e shkallës së parë vendimin e vet e ka bazuar në faturën me shenjën evidentuese Nr. DFE# 9003275 nga e cila ka konstatuar se i padituri ka pasur borxh shumën prej 17,894.44 €, të njëjtin nuk e ka paguar andaj bazuar 262 të LMD-së, e ka detyruar të paditurin që këtë shumë t’ia paguaj paditësit.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë sipas detyrës zyrtare e në bazë të nenit 194 të LPK e vlerëson aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë brenda kufijve të shkaqeve ankimore të theksuara në ankesë, duke i vështruar sipas detyrës zyrtare shkeljet thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par. 2 nën pikën b), g), j), k) dhe m) të këtij ligji dhe aplikimin e drejtë të së drejtës materiale.

Gjykata e shkallës së dytë ka gjetur se aktgjykimi i atakuar është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par.1 dhe 182 par. 2 pika n), për arsye se aktgjykimi ka të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet, dispozitivi i aktgjykimit është i pakuptueshëm dhe kontradiktor me vetveten dhe me arsyet e aktgjykimit, nuk janë treguar arsyet për faktet vendimtare respektivisht arsyet e dhëna janë të paqarta, ekzistojnë kundërtënie për faktet vendimtare midis asaj që jepet në arsyet e aktgjykimit dhe dokumenteve të administruara si prova.

Në dispozitivin e aktgjykimit të atakuar detyrohet i padituri ta paguaj borxhin në shumën prej 17,894.44, por nuk përcaktohet se për cilën periudhë kohore është krijuar ky borxh. Ky fakt është me rëndësi për vendosje në këtë çështje nga shkak se i padituri ka pretenduar faljen e borxhit dhe parashkrim andaj përcaktimi i periudhës kohore të borxhit respektivisht datave të dorëzimit të faturave, përbën çështje thelbësore për vendosje dhe përcakton objektin e kontestit për të cilin vendoset në mënyrë meritore. Poashtu në dispozitiv detyrohet e paditura që ta paguaj kamatën vjetore të llogaritur nga data 21.11.2011 por nuk përcakton fare normën e kamatës. Të metat e tilla e bëjnë aktgjykimin të pa ekzekutueshëm.

Gjykata e shkallës së parë nuk e ka vërtetuar në mënyrë të plotë gjendjen faktike sepse edhe në arsyetimin e aktgjykimin nuk theksohet fare se për cilën periudhë është shkaktuar borxhi kontestues dhe nuk janë dhënë fare arsye se nga cilat prova gjykata e ka konstatuar ekzistimin e detyrimit.

Shkeljet e tilla përfaqësojnë shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore që kanë pasur ndikim në marrjen e aktgjykimit të ligjshëm dhe të drejtë andaj aktgjykimi i atakuar doemos është dashur të priset.

Në ri-procedurë gjykata e shkallës së parë duhet evituar shkeljet e theksuara më lartë , në atë mënyrë që të eviton kundërthëniet ekzistuese në mes dispozitivit me arsyetimin, arsyetimit me faktet vendimtare dhe me arsyet e theksuara për çështjet kryesore dhe sipas nevojës të nxjerrë provat e nevojshme për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, e pas kësaj të merret vendim i ligjshëm dhe i drejtë.

Nga të cekurat u vendos sikurse në vendim në bazë të nenit 195.1 nën pikën c) të LPK.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS ,
Ae.nr.27/2016, dt.10.10.2017**

**KRYETARI I KOLEGJIT,
Mahir Tutuli,d.v.**